



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ /2018

**“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9975, DATË
28.7.2008 ‘PËR TAKSAT KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve: 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

VENDOSI:

Neni 1

Në germën “b”, të pikës 5, të nenit 2, të shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR, kur mjeti regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit për efekt të klasifikimit “Automjet luksoz” reduktohet çdo vit me 10 % të vlerës së mbetur”.

“Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre për efekt klasifikimi si “Automjet luksoz”, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar sipas paragrafit të mësipërm”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 3, bëhen këto ndryshime:

- Togfjalëshi “prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit” zëvendësohet me togfjalëshin “sipas nenit 114 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.
- Togfjalëshi “18 për qind” zëvendësohet me “togfjalëshin 25 për qind”.

Neni 3

Në nenin 7 “Taksa që vilet nëpërmjet pullës”, hiqet togfjalëshi “ janë taksa vjetore e mjeteve te perdorura dhe” zëvendësohet me fjalën “është”.

Neni 4

Në germën “g”, e pikës 2, të nenit 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, togfjalëshi “0 (zero) përqind” zëvendësohet me togfjalëshin 5(pesë) përqind”.

Neni 5

Në nenin 9 “Përjashtimi nga pagimet e taksave kombëtare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në pikën 1 në germën “ç”, pas togfjalëshit “invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë” shtohet togfjalëshi “personat me aftësi të kufizuar”.
- Pas germës “d”, të pikës 1, shtohet pika “e” me këtë përmbajtje:
“ e. Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.
- Pas germës “ç”, të pikës 7, shtohet pika “d” me këtë përmbajtje:
“d. Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.

Ky ligj hyn në fuqi në 1 janar dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R

GRAMOZ RUCI